



A.nr.595/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi, dhe Malësore Gashi Bajraktari anëtare, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.595/2026, të datës 03.06.2026, të parashtruar nga ankuesi E.Z, S.I-V, S.U të cilët me autorizim e përfaqëson shoqëria e avokateve “Klinaku Associates L.L.C”, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 28.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.595/2026, e datës 03.06.2026, e parashtruar nga ankuesi E.Z dhe S.I të cilën me autorizim e përfaqëson shoqëria e avokateve “Klinaku Associates L.L.C”, nga Prishtina.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesës me numër A.nr.595/2026 të parashtruar nga ankuesja S.U të cilën me autorizim e përfaqëson shoqëria e avokateve “Klinaku Associates L.L.C”, nga Prishtina.

A r s y e t i m

Ankuesit E.Z S.I-V dhe S.U më datë 03.06.2026, përmes përfaqësuesit me autorizim avokateve “Klinaku Associates L.L.C”, nga Prishtina, kanë parashtruar ankesën me numër protokoli 2545/2026 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër Përgjigjes në kërkesë të datës 05.05.2026 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me pretendimin mbi të drejtën e kompensimit të përvojës së punës nga 0.25% në 0.5%, nga koha kur ha hy në fuqi Ligji i Pagave në Sektorin Publik dhe në vazhdimësi në 0.5%.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.06.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit të Prokurorial të Kosovës, ndërsa, kjo e fundit më datë 19.06.2026, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 2545/2026 të datës 03.06.2026, e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Përgjigjen me numër protokoli 679/2026 të datës 06.05.2026; Kërkesën e datës 23.04.2026. Autorizimet lidhur me përfaqësimin e ankuesve nga shoqëria e avokateve “Klinaku Associates L.L.C”; Akt emërimit të datës 01.08.2024 të ankuesit si dhe dokumentin e identifikimit

S.V; Listat e pagave për muajin Maj 2023 deri me muajin Janar 2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 12.06.2026; Përgjigjen në ankesë të datës 19.06.2026 me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa si në pikën **I** të dispozitivit është e pabazuar, **sepse**:

Nga shqyrtimi i provave të administruara rrjedhë së ankuesit si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimit, posedojnë Akt të Emërimit respektivisht ankuesi E.Z sipas akt emërimit mbanë pozitën e punës Referent i Regjistrimit, ndërsa ankuesja S.I.V sipas aktit të emërimit mbanë pozitën e punës Bashkëpunëtor Profesional në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe rrjedhimisht, kanë statusin e nëpunësit të shërbimit civil.

Ankuesit fillimisht me datë 28.04.2026 kanë parashtruar kërkesë Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial lidhur me kompensimin në emër të shtesës në pagë-përvojës se punës nga 0.25 % në 0.5%, ndërsa ky i fundit me datë 06.05.2026 përmes përgjigjes me numër 679/2026 ka refuzuar kërkesën e ankuesve me arsyetimin se në përputhje me aktgjykimin KO79/23 të datës 23.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe duke pasur parasysh mungesën e një bazë ligjore për realizimin e shtesës prej 0.25% për përvojën e punës kërkesa duhet të refuzohet.

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë se punëdhënësi me rastin e refuzimit të kërkesës lidhur me kompensimin e shtesës për përvojën e punës është juridikisht i paqëndrueshëm jo ligjor dhe kontradiktor, të njëjtit kërkojnë që të aprovohet ankesa si e bazuar në tërësi të anulohet përgjigja e organit të punësimit dhe të detyrohet punëdhënësi të paguaj në emër të kompensimit për vlerën sipas përvojës se punës nga 0.25% deri në 0.50% nga koha kur ka hyre Ligji i Pagave në fuqi e tutje.

Lidhur me pretendimin e ankueses referuar kompensimit lidhur me përvojën e punës, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 6 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me të cilin është përcaktuar se: *“6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë”,* dispozita këto të cilat i janë nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, më ç’rast, kjo e fundit, me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, në pikën II të dispozitivit ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrotja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrotja e pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ndërsa, në pjesën arsyetues gjegjësisht në pikët 380 dhe 381 ka sqaruar: 380. *Gjykata ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) dhe paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit. Kjo, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ndër të tjera, sepse (i) zbritja joproporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës është në kundërshtim të plotë me parimet kushtetuese, ligjore, parimet relevante ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe përtej cenimit të të drejtave respektive individuale, rezulton edhe në cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës;....ndërsa (v) përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës. 381. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna më sipër ndërlidhur dhe me efektin e Aktgjytimeve të Gjykatës, kjo e fundit (i) nuk do të shfuqizojë paragrafin 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, ndërsa (ii) do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. 382 Kjo sepse,*

*lidhur me paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me shtesën mbi pagën për përvojën e punës, Ligji i kontestuar në paragrafin 1 të nenit 45 të tij, ka shfuqizuar edhe Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, i cili përfshin nenin 18 (Shtesa mbi pagën për përvojën e punës) sipas të cilit, për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil sipas këtij ligji i takon e drejta shtesë në pagën bazë prej zero pikë pesë përqind (0,5%). Shpallja e pavlefshme e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar i kombinuar me faktin që Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë shfuqizohet gjithashtu përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar, do të rezultonte në zbrazëti ligjore, përkitazi më të drejtën për shtesa mbi pagën për përvojën e punës. Për pasojë, duke balancuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat dhe liritë themelore, Gjykata do të lë **në fuqi paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në periudhën prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi.** Në ndryshimin dhe/ose plotësimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Kuvendi duhet të ketë parasysh që efektet e ndryshimit/plotësimit të tij në kontekst të lartësisë së shtesës për përvojën e punës burojnë që nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi”.*

Andaj, duke qenë se Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese nuk ka bërë plotësim/ndryshimin e paragrafi 6 të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Këshilli në mungesë të këtij rregullimi ligjor, nuk ka juridiksion ligjor që të detyroj institucionet publike të bëjnë kompensimin e përvojës së punës për zyrtarët publikë sipas interpretimit kushtetues dhe rrjedhimisht mbi këtë bazë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk mund të trajtoj në meritë pretendimit ankimor lidhur me kompensimin për përvojën e punës sikurse pretendohet në ankesë, kështu që, pretendimi ankimor mbi rrethanat ekzistuese nuk ka mbështetje ligjore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit si në pikën **II** të dispozitivit, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja S.U e punësuar në pozitën e punës referente në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial, sipas vendimit me numër 133/2024 të datës 24.01.2024 i ndërpritet marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit nga data 28.01.2024.

Andaj në kuptim të përcaktimit të kompetencës së Këshillit për shqyrtim dhe vendosje lidhur me këtë çështje administrative, sipas pikës II të dispozitivit, Kolegji i Këshillit ju referuar dispozitat e ligjit material që rregullon marrëdhënien e punës në shërbimin civil, gjegjësisht nenin 73., paragrafin 1, nën paragrafi 1.4, të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se; *1. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon për rastet e përcaktuara në ligj, kur 1.4. mbushet moshë për pensionim sipas Ligjit të Punës, ndërlidhur me nenin 5, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4, të Rregullores (QRK) NR.29/2024 për Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se; 1. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon në rastet si në vijim: arrihet moshë për pensionim sipas Ligjit përkatës për Punës, rrjedhimisht, në kuptim të kësaj dispozitive ligjore si dhe duke u bazuar në konstatim e gjendjes faktike përkatësisht vendimin me numër protokolli 133/2024, të datës 24.01.2024 të nxjerr nga Drejtori i Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes të cilit vendimi ankueses, i ka përfundua marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit nga data 28.02.2024, bazuar në konstatimet si me lartë, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesja nuk ka statusin e nëpunësit civil, as të kandidatit për pranimin në shërbimin Civil të Kosovës.*

Theksuar si më sipër, Kolegji bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA, A.nr.595/2026

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Eshref Shabani

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit me autorizim shoqëria e avokateve Klinaku Associates L.L.C.
- Drejtorit të Përgjithshëm dhe Njesisë së Burimeve Njerëzore në SKPK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.